



22140007



ALBANIAN A: LITERATURE – STANDARD LEVEL – PAPER 1
ALBANAIS A : LITTÉRATURE – NIVEAU MOYEN – ÉPREUVE 1
ALBANÉS A: LITERATURA – NIVEL MEDIO – PRUEBA 1

Friday 9 May 2014 (morning)
Vendredi 9 mai 2014 (matin)
Viernes 9 de mayo de 2014 (mañana)

1 hour 30 minutes / 1 heure 30 minutes / 1 hora 30 minutos

INSTRUCTIONS TO CANDIDATES

- Do not open this examination paper until instructed to do so.
- Write a guided literary analysis on one passage only. In your answer you must address both of the guiding questions provided.
- The maximum mark for this examination paper is *[20 marks]*.

INSTRUCTIONS DESTINÉES AUX CANDIDATS

- N'ouvrez pas cette épreuve avant d'y être autorisé(e).
- Rédigez une analyse littéraire dirigée d'un seul des passages. Les deux questions d'orientation fournies doivent être traitées dans votre réponse.
- Le nombre maximum de points pour cette épreuve d'examen est *[20 points]*.

INSTRUCCIONES PARA LOS ALUMNOS

- No abra esta prueba hasta que se lo autoricen.
- Escriba un análisis literario guiado sobre un solo pasaje. Debe abordar las dos preguntas de orientación en su respuesta.
- La puntuación máxima para esta prueba de examen es *[20 puntos]*.

Shkruaj një analizë të drejtuar letrare duke u bazuar në vetëm një tekst. Në përgjigjen tuaj duhet t'i drejtoheni të dyja pyetjeve udhëzuese.

1.

Studentët shqiptarë që kanë studiuar jashtë shtetit, veçanërisht në Itali, Austri e Gjermani, nuk janë të pakët. Një pjesë e mirë e tyre i përkasin qytetit të Elbasanit. Prezantimi dinjitoz i tyre vinte edhe për shkak të shkollimit në Normalen e këtij qyteti që mori përmasat e vërteta të një universiteti për vetë shkollën e njohurive dhe cilësinë e tyre. Aq më tepër që edhe profesorët që jepnin mësim në këtë Normale ishin të ardhur nga perëndimi dhe me një botë të pasur njohurish dhe vlerash. Nuk janë të paktë as ata që mbrojtjet e tyre të diplomave i bënë për tema të rëndësishme që ktheheshin më pas edhe në studime të mirëfillta, deri në baza për thellime të mëtejshme akademike.

Një ekselencë ka qenë edhe ai i një personaliteti me “Përfaqësimi politik në Shqipëri, nga antikiteti deri në vitin 1928” i noterit, doktor në drejtësi Kristaq Stratti, e shkruar në dekadën e dytë të shekullit XX. Ky studim e pa dritën e botimit pas më shumë se 80-vjetësh harresë që është diskutuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Studimeve të Torinos, dhe sot ruhet në Arkivin Historik të Universitetit, më 23 nëntor 1928. Ky disertacion meriton të botohet jo vetëm për temën e trajtuar, por edhe për rëndësinë historike që lidh jetën e Kristaq Strattit me ngjarjet e dy vendeve, Italisë dhe Shqipërisë. Në vitet XX, përfaqësimi politik ishte një temë shumë aktuale dhe pak e studiuar në shtetin e ri shqiptar. Gjithsesi, ishin hapat e para të një pluralizmi tipik të kohës i huazuar nga Europa që e kishte aplikuar si të tillë dhe model të demokracisë.

Kristaq Stratti ka qenë një nga të parët që theksonte rëndësinë e ndershmërisë dhe arsimit të lartë si mjet themelor dhe i pazëvendësueshëm në zhvillimin e demokracisë në vend.

Po si të gjithë intelektualët e shquar shqiptarë që pas të ashtuquajturit çlirim të Shqipërisë, edhe për Kristaq Strattin nisi kalvari i vuajtjeve të tij nga 16 maj 1947 me arrestimin nën regjimin diktatorial të Enver Hoxhës, që persekutonte jo vetëm kundërshtarët politikë, por mbi të gjitha intelektualët dhe profesionistët që kishin studiuar jashtë shtetit. Kristaq Stratti u arrestua dhe u torturua. Gjatë një procesi fals u dënua me 15 vjet burg dhe me punë të detyruar. Pronat iu konfiskuan dhe familja e tij u dëbua. Akuza e dënimit krejtësisht false: “Grupazh për përmbysjen e pushtetit popullor dhe komplikim me klerin ortodoks grek”, që ishin kthyer në moto e regjimit që me injorancën e vet nuk dinte të gjente argumente, por vetëm me postulate të tilla farse kreu të ashtuquajturat gjyqe politike. Të gjithë bashkëqytetarët e tij, e njihnin atë djalë të ri, intelektual të rrallë, fisnik si në pamje, dhe në sjellje, të zotë në profesionin e noterit, përherë buzagaz, të sjellshëm me gjithë njerëzit.

Vetë kushtet e familjes, e cila për traditë kishte pasur brez pas brezi zhvillimin intelektual dhe tregtar në qytetin bregdetar me tradita patriotike të Vlorës ku babai i tij, Pandeli Stratti ishte një nga tregtarët më të njohur dhe të respektuar në Vlorë, bëri të mundur arsimimin e fëmijëve të tij.

Vitet e rënda të burgut dhe puna sflitëse në kushte çnjerëzore në “kampet e punës së detyruar”, si në atë të tharjes së kënetës së Maliqit, në Beden, Burrel, Gjirokastrë, Ura Vajgurore etj nuk përkulën guximin dhe karakterin e tij.

Në moshën 50-vjeçare, Kristaq Stratti kapërcente pragun e “lirimit”, por jo të lirisë. Nga gjithë ai kalvar mundimesh ku si për mrekulli të Zotit doli, as në sy dhe as në shpirt, nga gjithë
40 ç’kishte parë e ç’kishte hequr nuk do t’i bëhej as një hije e rëndë urrejtjeje, duke mbajtur gjithçka brenda tij dhe duke mos u ankuar asnjëherë. Bashkohet me familjen e tij të dashur, gruan e tij të mrekullueshme dhe të shkolluar në shkollën e famshme “Liceu Kiriaz”, Ksanthipi Dovana Stratti dhe fëmijët e tij Pandeli Strattin, matematikanin, me titull “Mësues i nderuar” dhe Geraldinën, mësuese. Në vend që të ushtronte aktivitetin profesional, është i detyruar të punojë si punëtor i
45 thjeshtë ndërtimi.

Është ky njeri që shkëlqente në një shtet si Italia dhe u persekutua në vendin e tij, për shkak të intelektualizmit që kishte dhe për vlerat që mbarte, po aq sa edhe u vepra kështu edhe ndaj shumë e shumë bijve të kombit siç ishte edhe Kujtim Sharra që kishte studiuar në Austri dhe që ishte një nga të shkëlqyerit e atij vendi që në Shqipëri e pushkatuan siç bëri për shumë burra
50 me vlera të papërsëritshme. Puna e Kristaq Strattit që ishte një punë shumëvjeçare shkencore et morri në dritë pas shumë përpjekjeve dhe kërkimeve të vajzës së djalit të tij. Është një homazh që vjen nga nderimi që duhet të kemi për burrat të tillë si Kristaq Stratti, për të kërkuar ndjesë para drejtësisë që shpesh harrohen dhe që meritojnë të kujtohen në çdo kohë.

Marica Pistulli, *Shqipëria sot* (2011)

- (a) Diskuto se si rëndësia e lirisë është paraqitur në këtë pjesë.
- (b) Komento mbi rëndësinë e strukturës të përdorur në këtë pjesë.

2.

Trungu ilir

Ky qytet është krenar me shtatin e saj dhe madhësinë,

Me makinë e ben per një orë,
Në këmbë njëqind vjet,
Duke numëruar pemët, burimet dhe këngët,

5 Të varreve dhe monumentet.
Tre brezat e vjetër, kur të keni arritur,
Me peshën e kohës mbi kurrizin tuaj.

I sëmurë i lodhur e i vetmuar,
Ju gjeni një shtëpi në qytetin e lashtë,

10 Ruajtur nga dy burrat e vjeter,
Një me një kravatë dhe gazeta,
Një kapele dhe pistoletë, tjetri.

Ju matni moshën tuaj dhe vetminë tuaj
Në tokë plasaritur, çatitë thërrmuar,

15 Të oxhaqeve pa tym,
Dhe të masni fjalët dhe mendimet.

Kalaja sipër jush është e heshtur
Me dhëmbët e vjetra se vete kalaja,
Kush ka njohur vetmi më shumë:

20 Kalaja, lumi ose ju,
Ose Prizreni vete, si qytet i lashtë?

Sabri Hamiti, *Trungu ilir* (1983)

(a) Komento mbi përdorimin e metaforave në këtë poezi.

(b) Si është përshkruar vetmia në këtë poezi?